

UDHËZIM
Nr. 47, datë 1.2.2021

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 298, DATË 10.9.2020, “PËR PROCEDURAT
E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të neneve 49, 50, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të dekretit nr. 11700, datë 6.9.2020, të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 298, datë 10.9.2020, “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”, bëhet shtesa si vijon:

1. Në pikën 19 të udhëzimit nr. 298, datë 10.9.2020, shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

“Shtetasit, të cilëve më 25.4.2021, në datën e zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, u ka përfunduar afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik identifikohen të markuar në formatin e ekstraktit të përbërësve zgjedhorë dhe të listës përfundimtare të zgjedhësve.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi